BPrAL AAB
INSTITUCIONI I ARSIMIT UNIVERSITAR

FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

HYRJE – NATYRA E PROJEKTËVE TË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

LËNDA: MENAXHIMI I PROJEKTËVE TË TI-së

Ligjërues: MSc. Artan DRESHAJ

HYRJE

- Projektet e Teknologjisë Informative (TI) janë investime organizative.
- Kur një organizatë e ndërton ose implementon një zgjidhje të TI-së, kjo kërkon
  - kohë të konsiderueshme,
  - të holla,
  - dhe burime për projektim,
  - Gjithë kjo realizohet në pritje të marrjes diçka me vlerë në kthim.
- Për më rritë shanset e suksesit të projekteve është zhvilluar disiplina e re e quajtur Menaxhimi I Projekteve të Teknologjisë Informative (Information Technology Project Management - ITPM).
- Ndërtimi i një sistemi informativ ndryshon nga ndërtimi i një shtëpie, një ure ose i një rakete për udhëtim në hapësirë.

ÇKA ËSHTË PROJEKTI?

- Instituti I Menaxhimit të Projektit (Project Management Institute - PMI), një organizatë që u themelua në vitin 1969, është zgjeruar dhe ka arritur që të bëhet shoqata profesionale kryesore jo-fitimprurëse në fushën e menaxhimit të projektit.
- Disa prej definicioneve kryesore për projektin sipas PMI janë:
  - Një projekt është një përpjekje e përkohshme e ndërmarrë për të përmbushur një produkt, shërbim, apo rezultat unik.
  - Menaxhimi i projektit është aplikimi i njohurive, shkathtësive, mjeteve dhe teknikave në aktivitetet e projektit për të përmbushur kërkesat e projektit.
  - Një menaxher i projektit është personi i caktuar nga organizata për të arritur objektivat e projektit.
- Projektet po ashtu kanë atributet e tyre ku përfshihen:
  - Afatet kohore, Për shkak se një projekt është një përpjekje e përkohshme, ajo duhet të ketë një fillim të caktuar dhe fundin.

ÇKA ËSHTË PROJEKTI? – (2)

- **Qëllimin** - Projektet janë ndërmarrë për të kryer diçka. Një projekt IT mund të prodhojë ndonjë numër të rezultateve-një sistem, një paketë softueri, ose një rekomandim të bazuar në një studim. Prandaj, qëllimi i një projekti duhet të jetë për të prodhuar diçka të prekshme dhe të vlerës për organizatën.
- **Pronësia -** Projekti duhet të sigurojë diçka me vlerë për një individ apo grup i cili do të zotërojë produktin e projektit, pasi që të jetë përfunduar.
- **Resurset -** Projektet e TI-së kërkojnë kohë, para, njerëz dhe teknologji. Resurset sigurojnë mjetet për arritjen e qëllimit të një projekti dhe gjithashtu veprojnë si një pengesë.
- **Rolet -** Projektet e TI-së kërkojnë individë të ndryshme me grupe të ndryshme të aftësive. Edhe pse këto aftësi mund të jenë të ndryshme për projekte të ndryshme, një projekt tipik mund të përfshijë si në vijim:
  - Menaxherin e projektit ose liderin - Menaxheri i projektit apo i ekipit udhëheqës është përgjegjës për të siguruar që të gjitha proceset e menaxhimit të projektit dhe të zhvillimit teknik janë në vend dhe janë duke u kryer brenda një numri kërkesash specifike, proceseve të përcaktuara, dhe standardeve të cilësisë.

ÇKA ËSHTË PROJEKTI? – (3)

- Sponzoruesin e projektit - Sponsor i projektit mund të jetë klienti, konsumatori, ose menaxher organizativ i cili do të veprojë si një kampion për projektin dhe të sigurojë burimet organizative dhe drejtim kur është e nevojshme.
- Eksperti I fushës - Eksperti i fushës mund të jetë një përdorues ose klient i cili ka njohuri specifike, ekspertizë, ose depërtim në një zonë specifike funksionale të nevojshme për të mbështetur projektin.
- Ekspertët teknik - Ekspertët teknike janë të nevojshëm për të siguruar një zgjidhje teknike për një problem organizativ. Ekspertë teknikë mund të përfshijnë sistemet e analistëve, specialistë të rrjetit, programuesit, artistë grafike, trajnerët, etj.

- **Rreziqet dhe Supozimet** - Të gjitha projektet kanë një element të rrezikut, dhe disa projekte sjellin më shumë rrezik se të tjerët. Rreziqet mund të lindin nga shumë burime, mund të jenë të brendshme dhe të jashtë ekipit të projektit.
- **Detyrat ndërvarura** – Puna në projekt kërkon shumë detyra të ndërvarura.

ÇKA ËSHTË PROJEKTI? – (4)

- **Ndryshimet organizative** - Projektet janë planifikuar që të realizojnë ndryshime organizative. Ndryshimi duhet të kuptohet dhe menaxhohet sepse implementimi i projektit të TI do të ndryshojë mënyrën se si njerëzit punojnë.
- **Operimi në një mjedis më të madh se në vetë projektin** - Organizatat zgjedhin projekte për një numër arsyesh, dhe projektet e zgjedhura mund të ndikojnë organizatën. Është e rëndësishme që menaxheri i projektit dhe ekipi të kuptojnë kulturën, mjedisi, politika dhe dëshirat e kompanisë.

SITUATA AKTUALE NË MENAXHIMIN E PROJEKTËVE TË TI-së

- Edhe pse janë duke u bërë më të besueshme, më të shpejta, dhe më pak të kushtueshme, kostot, kompleksiteti, dhe rreziqet e menaxhimit të projekteve të TI-së vazhdojnë të jenë një sfidë për shumë organizata.
- Sipas një studimi të realizuar më 1994 më 365 Menaxherë të TI-së nga Standish Group, ka tërhequr vërejtjen për atë që shumica e quajtën krizat e softuerit (software crisis).
- Studimi ishte quajtur CHAOS dhe nga aty ishte raportuar që vetëm 16% e projekteve të zhvillimit të aplikacioneve, ishin të suksesshme në terma të kompletimit në kohë dhe brenda buxhetit të paraparë.
- 31 % e projekteve ishin anuluar para përfundimit, përderisa 53 % ishin kompletuar mirëpo jo brenda buxhetit dhe afatit kohor të paraparë, dhe nuk janë përputh më specifikat origjinale të përgatitura në fillim të projektit.

SITUATA AKTUALE NË MENAXHIMIN E PROJEKTËVE TË TI-së - (2)

- Përmbledhje e studimeve CHAOS nga viti 1994-2008.
  - Të suksesëshme,
  - Të sfiduara,
  - Të dështuara.



SITUATA AKTUALE NË MENAXHIMIN E PROJEKTËVE TË TI-së – (3)

- Përmbledhja e studimit CHAOS më renditje të faktorëve për sukses të projekteve.

Rënditja	1994	2001	2006	2008
1	Përfshirja e përdoruesve	Përkrahja ekzekutive	Përfshirja e përdoruesve	Përfshirja e përdoruesve
2	Përkrahja e menaxhmentit ekzekutiv	Përfshirja e përdoruesve	Përkrahja e menaxhmentit ekzekutiv	Përkrahja ekzekutive
3	Deklarim i qartësuar i kërkesave	Eksperienca e menaxherit të projektit	Objektiva të qartësuara të biznesit	Objektiva të qartësuara të biznesit
4	Planifikimi i duhur	Objektiva të qartësuara të biznesit	Optimizimi i fushëveprimit	Maturimi emocional
5	Pritjet reale	Minimizimi i fushëveprimit	Proces i shkathët (agil)	Optimizimi i fushëveprimit
6	Ndarja e projektit në detyra më të vogla	Infrastruktura standarde e softuerit	Ekspertiza e menaxhmentit të projektit	Proces i shkathët (agil)
7	Stafi kompetent	Kërkesat themelore të firmes	Menagjimi financiar	Ekspertiza e menaxhmentit të projektit
8	Pronësia	Metodologjia formale	Resurset e kualifikuara	Resurset e kualifikuara
9	Vizion dhe objektiva të qartësuara	Vlersime të besueshme	Metodologjia formale	Ekzekutimi
10	Punë e përkushtuar, ekipi I fokusuar	Të tjera	Veglat standarde dhe infrastruktura	Veglat standarde dhe infrastruktura

SITUATA AKTUALE NË MENAXHIMIN E PROJEKTËVE TË TI-së - (4)

- Sipas një studim tjetër më 800 menaxherë të lartë të TI-së nga Britania e Madhe, Shtetet e Bashkuara, Franca, Gjermania, India, Japonia, dhe Singapori kryer nga Tata Consultancy Services (2007) raporton rezultatet e tmerrshme të ngjashme me studimet CHAOS sipas të cilës:
  - 62 % e projekteve të TI-së dështojnë për të përmbushur oraret e tyre
  - 49 % përjetojnë tejkalim të buxhetit
  - 47 % kanë përjetuar kosto më të lartë të mirëmbajtjes se sa pritshmëria
  - 41 % kanë dështuar për të dhënë vlerën e pritshme të biznesit dhe kthimin në investime
- Një kritikë për studimet e CHAOS është se suksesi i projektit është përcaktuar në termat nëse projektet janë përfunduar në kohë, brenda-buxhetit, dhe nëse kjo përfshinte të gjitha tiparet e planifikuara dhe funksionalitetin.
- Një tjetër kritikë është se normat e suksesit / dështimit të studimeve CHAOS mund të jetë i dyshimtë nëse organizatat e përcaktojnë suksesin ndryshe.

PSE DËSHTOJNË PROJEKTET E TI

- Një arsye për normat e larta të dështimit në studimet CHAOS mund të jetë mënyra e definimit të “ i suksesshëm" dhe “i dështuar".
- Për shembull Robert Glas (2005) pyet, si duhet një projekt të klasifikohet në qoftë se ajo është "funksionalisht i shkëlqyer", por është mbi buxhetin dhe mbi orarin me 10 për qind?
- Sipas një web sondazhi të realizuar nga Computing Technology
- Industry Association (CompTIA), rreth 28 % nga 1000 respondend janë shprehur që komunikimi I keç është arsyeja kryesore e dështimit, 18 % janë përgjigjur që janë resurset e pamjaftueshme, dhe 13.2 % mendoj qe afatet kohore jo realiste janë arsyeja e dështimit.
- Studimet CHAOS gjithashtu japin disa njohuri interesante se pse disa projekte dështojnë.
- Tabela më nivelet dhe arsyet e dështimit është paraqitur në vijim I studiuar nga CHAOS.

PSE DËSHTOJNË PROJEKTET E TI – (2)

Rënditja	Faktorët për projektet e sfiduara	Faktorët për projektet e dështuara
1	Mungesa e inputit nga përdoruesit	Kërkesat e pakompletuara
2	Kërkesat e pakompletuara	Mungesa e përfshirjes së përdoruesve
3	Ndryshimi kërkesave dhe specifikimeve	Mungesa e resurseve
4	Mungesa e përkrahjes ekzekutive	Pritjet jorealiste
5	Paaftësia në teknologji	Mungesa e përkrahjes ekzekutive
6	Mungesa e resurseve	Ndryshimi kërkesave dhe specifikimeve
7	Pritjet jorealiste	Mungesa e planifikimit
8	Objektiva të paqartësuara	Nuk nevojitet më gjatë
9	Korniza kohore joreale	Mungesa e menaxhmentit të TI-së
10	Teknologjia e re	Mos njohja e teknologjisë

PËRMIRËSIMI, GJASAT E SUKSESIT

- Si mund të përmirësojmë shanset që projektet e TI-së të kenë sukses dhe që të shmangim përsëritjen e gabimeve të së kaluarës?
- **Qasja Vlera-Drejtimi** - Qartë dhe thjeshtë: Projektet e TI-së duhet të sigurojnë vlera të organizatës.
- Njerëzit dhe organizatat e definojnë projektin e suksesshëm nëse përfundon në kohë dhe brenda buxhetit të planifikuar. Këta dy parametra janë shumë të rëndësishëm mirëpo jo të mjaftueshëm.
- Çka do të ndodhë nëse një projekt përfundon në afatin dhe buxhetin e paracaktuar mirëpo sistemi nuk funksionon siç pritej?
- Çfarë vlere do të fitojë organizata duke shpenzuar 6 muaj dhe 1 milion $ në këtë llojë projekti?
- Vlera do të vijë nëse ofrohen shërbime më të mira për klientët, procese më efektive të biznesit, kosto më të ulëta, zgjerim tregu, etj.
- Suksesi nuk duhet të matet në terme të kohës ose buxhetit, por në terma të vlerës

PËRMIRËSIMI, GJASAT E SUKSESIT – (2)

- **Qasja socio-teknike.**
- Në të kaluarën, organizatat janë përpjekur për të përmirësuar shanset e suksesit të projekteve të TI-së duke u përqendruar në mjetet, teknikat dhe metodologjitë e zhvillimit të TI-së.
- Ne lehtë mund të përfundojmë zhvillimin e një aplikacioni që askush nuk pyet apo nuk i nevojitet.
- Ne duhet punojmë gjatë në definimin e kërkesave të përdoruesit, duke u zhdukur për disa muaj, dhe pastaj duke trokitur në derën e përdoruesit kur është koha për të ofruar sistemin e ri.
- Profesionistët e TI-së duhet të kuptojnë punë (biznesin) dhe të jenë krijues në mënyrë aktive në aplikimin e teknologjisë në atë mënyrë që të sjellin vlerë për organizatën.
- Aplikimi i suksesshëm i teknologjisë dhe arritja e qëllimit të projektit duhet të jetë një përgjegjësi e barabartë për zhvilluesit dhe përdoruesit.

PËRMIRËSIMI, GJASAT E SUKSESIT – (2)

- **Qasja** Projekt-Menaxhment.
- Aplikimi i parimeve të menaxhimit të projektit dhe mjeteve në të gjithë organizatën, mirëpo, duhet si pjesë e një metodologjie-radhitja dhe ndarja e aktiviteteve hap pas hapi, proceseve, mjeteve, standardeve të cilësisë, kontrolleve dhe dorëzimit që janë të përcaktuara për të gjithë projektin.
- Suksesi i projekti nuk varet kryesisht në ekip, por më shumë në grupin e proceseve dhe të infrastrukturës në vend.
- Arsyeja që menaxhimi I projektit duhet të përkrah projektet e TI-së përfshin:
  - Resurset
  - Pritjet
  - Konkurrencën
  - Efiqencën dhe efektivitetin

PËRMIRËSIMI, GJASAT E SUKSESIT – (3)

- **Qasja** Njohuri-Menaxhment.
- Menaxhimi i njohurive është një proces sistematik për fitim të njohurive, duke krijuar, sintetizuar, ndarjen, dhe duke përdorur informacionin, njohuritë, dhe përvojat për transformimin e ideve në vlerë të biznesit.
- Çka do të thotë mësimi nga përvoja?
- Përvoja mund të jetë mësuesi më i madh.

FUSHAT E NJOHURIVE PËR MENAXHMENTIN E PROJEKTIT

- PMBOK® Guide përcakton nëntë fusha të njohurive për kuptimin e menaxhmentit të projektit .



HYRJE – NATYRA E PROJEKTËVE TË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

- **PYETJE PËR KËTË KAPITULL?**